



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.309/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit F.K., degë e organizatës F. I., me seli në P., rr. "R.D.", nr., kundër debitorit M.D., nga K., rr. "L. e P.", nr., duke vendosur lidhur me parashtrësën - kërkesën për parregullsi të paraqitur nga debitori M.D., më datë 06.12.2023 në lëndën përmbarimore P.nr.316/21, të Përmbaruesit Privat S.A., në Gj., përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Klinë, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m

Ish Gjykata Komunale në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, F.K., degë e organizatës F.I., me seli në P., mbi bazën e dokumentit përmbarimor me aktvendimin Ek.nr.562/08, të datës 27.08.2008, ka lejuar urdhrin përmbarimor ndaj debitorëve F.Gj., P.Gj., M.D., L.B., V.Sh., dhe M.B., për realizimin e borxhit në shumë prej 6.529,70 euro.

Lënda në fjalë me kërkesë të kreditorit është transferuar për procedim të mëtejme te Përmbaruesi Privat S.A., në Gj., dhe është evidentuar me numër P.nr.316/21. Përmbaruesi Privat S. A., me kërkesën P.nr.316/21, të datës 23.11.2023 ka ftuar debitorët që në afat prej 8 ditësh të paraqiten pranë zyrës së përmbaruesit privat për të realizuar pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore në lëndën P.nr.316/21.

Ndaj kësaj kërkesë, debitori M.D., nga P., më datë 06.12.2023 ka paraqitur ankesën për evitimin e parregullsive duke i propozuar gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin-kërkesën për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve në lëndën përmbarimore P.nr.316/21, të datës 23.11.2023, dhe debitori M.D., të lirohet nga pagesa e borxhit të parashkruar.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, me aktvendimin CPP.nr.45/23, të datës 16.04.2024, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vepruar në këtë çështje juridiko - përmbarimore, sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit Institucioni Mikrofinanciar "F.", me seli në P., me numër E.nr.562/08, të datës 17.06.2021, kundër debitorit të përmbarimit: F.Gj., etj, me objekt përmbarimi pagesë e borxhit nga hua, me vlerë të objektit të kontestit 6.529,70 euro, për shkak të ekzistimit të kompetencës së shkallës së parë të Gjykatës Komerciale për këtë çështje përmbarimore. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, propozimi për përmbarim së bashku me shkresat tjera të lëndës i dërgohet në kompetencë Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.908/24, të datës 24.10.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Pejë - Dega Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur lidhur me ankesën për parregullsi të paraqitur nga debitori M.D., më datë 06.12.2023, në lëndën përmbarimore P.nr.316/21, e cila zhvillohet pranë Përmbaruesit Privat S.A., Në pikën II të dispozitivit është vendosur që, për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori F.K., degë e organizatës F. International, me seli në P., ka paraqitur propozim për përmbarim për sekuestrimin e kolateralit në bazë të dokumentit të besueshëm ndaj debitorëve F.Gj., P.Gj., M.D., L.B., V.Sh., dhe M.B., për realizimin e borxhit në shumë prej 6.529,70 euro. Pastaj lënda me kërkesë të kreditorit është transferuar për procedim të mëtejshëm te Përmbaruesi Privat S.A., në Gjilan. Përmbaruesi Privat S.A., me kërkesën P.nr.316/21, të datës 23.11.2023, ka ftuar debitorët që në afat prej 8 ditësh të paraqiten në zyrën e përmbaruesit privat për të realizuar pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore në lëndën P.nr.316/21 dhe kundër kësaj kërkesë, debitori M.D., nga P., ka paraqitur ankesë për evitimin e parregullsive duke i propozuar gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin-kërkesën për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve në lëndën përmbarimore të lartcekur. Më pas Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, me aktvendimin CPP.nr.45/23, të datës 16.04.2024, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të vendosur është Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Klinë, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i

shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, parashihet që: “Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”. Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”.

Marrë për bazë dispozitat ligjore të lartcekura Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike - përmbarimore, sipas kërkesës së debitorit M.D., nga P., për evitimin e parregullsive lidhur me urdhrin P.nr.316/21, të datës 23.11.2023, është Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Klinë. Kjo për faktin se me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cituara më lart erdhi në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me kërkesën - ankesën e ushtruar kundër urdhrit, gjegjësisht evitimin e parregullsive lidhur me urdhrin përmbarimor të lartcekur dhe sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me persona juridik, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare. Si rezultat i kësaj, sipas dispozitave ligjore të lartcekura, është kusht që palët të jenë persona juridik dhe njëkohësisht kontesti të ketë të bëjë me çështje të ndërsjella tregtare, pra të plotësohen këto dy kushte në mënyrë komulative, nëse njëra nga këto mungon atëherë nuk kemi të bëjmë me çështje tregtare dhe rrjedhimisht nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë dhe të Dytë, për të gjykuar në këtë çështje juridike.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
CN.nr.309/2024, datë 21.11.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Lumni Sallauka